VENDIM
Nr. 570, datë 11.10.2023

PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË REDUKTUAR PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË DISA AMBIENTEVE NË OBJEKTIN "REZIDENCA QEVERITARE, VILA 31 TIRANË", PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT KULTUROR "VILA ART REZIDENCË TIRANA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 8, të kreut III, të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifës së reduktuar për dhënien në shfrytëzim Ministrisë së Kulturës të disa ambienteve në objektin "Rezidenca Qeveritare, vila 31 Tiranë", për realizimin e projektit kulturor "Vila Art Rezidencë Tirana".
2. Vlera e tarifës së shfrytëzimit të ambienteve të objektit "Rezidenca Qeveritare, vila 31 Tiranë" do të jetë në masën ekuivalente të shpenzimeve për furnizimin me energji elektrike dhe ujë, si dhe koston e mirëmbajtjes e të trajtimit të këtyre ambienteve gjatë të gjithë periudhës së dhënies në shfrytëzim për këtë projekt.
3. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama